

# UNIVERSITETI I PRISHITNES

## FAKULTETI EKONOMIK

---

### Syllabus

#### LËNDA: MENAXHMENTI I BIZNESIT TË VOGËL DHE TË MESËM

Studimet : Bachelor

#### Qëllimi i Kursit

Lënda *Menaxhmenti i Biznesit të Vogël dhe të Mesëm* është dizajnuar që t'i familjarizojë studentët me konceptet fundamentale të ndërmarrësisë dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet ndërmarrësi në procesin e krijimit, rritjes dhe menaxhimit të biznesit. Qëllim kryesor i këtij moduli është që studentët të kuptojnë procesin përmes të cilit idetë ndërmarrëse zhvillohen, implementohen dhe menaxhohen sukseshëm. Moduli do të ketë në fokus zhvillimin e planit të biznesit.

#### Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

- Identifikojnë definicionet alternative të ndërmarrësit, ndërmarrësisë dhe bizneseve të vogla dhe të mesme (BVM).
- Vlerësojnë rolin e ndërmarrësisë dhe BVM në ekonominë kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Sqarojnë se si frimat krijohen, zhvillohen dhe rriten dhe se si roli i ndërmarrësit ndryshon në këtë proces.
- Diferencojnë në mes të fushave të ndryshme të menaxhimit që në fazën e themelimit e deri të rritja e biznesit.
- Identifikojnë barrierat me të cilat përballen ndërmarrësit dhe mënyrat për tejkalimin e tyre.
- Sqarojnë mjedisin e ndërmarrësisë.
- Përpilojnë një biznes plan solid lidhur me një ide ndërmarrëse.

#### Metodologjia e mësimdhënies:

Ky modul do të bazohet në ligjerata aktive dhe në punë ekipore të studentëve lidhur me krijimin e një ndërmarrje potenciale e cila do të rezultojë në një plan biznesi për idenë e tyre ndërmarrës. Ndër të tjera studentët do të inkurjohen të realizojnë një vizitë në një kompani (intervistë me një ndërmarrës). Puna grupore dhe individuale gjatë semestrit konsiston me përfundimin me sukses të dy projekteve nga të cilat njëri është projekt individual kurse tjetri është projekt grupor. Këto projekte janë:

**Projekti 1: Profili i Ndërmarrësit (projekt individual)** - Ky është një projekt individual në të cilin nga ju kërkohet që të zgjedhni një individ që ku konsideroni si ndërmarrës. Çdo person i cili i përgjigjet definicionit të ndërmarrësit të dhënë në literaturë është i pranueshëm për rast studimor. Detyra juaj është që të intervistoni këtë person dhe të shkruani një raport (2-3 faqe) lidhur me profilin e të intervistuarit. Profili përmban interesimin ndërmarrës të personit, motivimin, të dhënat tjera personale dhe filozofinë e përgjithshme të biznesit (aty ku është e aplikueshme). Për më tepër ju mund të prashtroni disa pyetje lidhur me mjedisin e biznesit në Kosovë për të analizuar perceptimet e ndërmarrësit lidhur me këtë mjedis. Ju do të administroni një pyetësor të ndërmarrësisë të cilin do ta përpiloni në bashkëpunim me profesorin e lëndës. Për më tepër Ju duhet që t'i kushtoni kujdes që në kuadër të intervistës të mbledhni informacione lidhur me karakteristikat personale të ndërmarrësit (për shembull biografia personale dhe familjare, motivet për tu bërë ndërmarrës) si dhe të dhëna të tjera lidhur me atë se si biznesi është duke performuar aktualisht (për shembull profitabiliteti, rritja, çshtjet e resurseve humane, produkti dhe shërbimet dhe planet e rritjes për të ardhmen.

## Projekti 2: Plani i Biznesit për Krijimin e Biznesit (projekt grupor)

Ky projekt është kryesor në kuadër të këtij moduli. Është një instrument kryesor i të mësuarit dhe zgjatë gjatë tërë semestrit. Në fund të semestrit secili grup duhet të ketë përpiluar një plan biznesi për idenë e zgjedhur ndërmarrëse. Studentët do të punojnë në grupe prej 3 ose 4 persona. Ky projekt kërkon që të jeni të familjarizuar me koncepte bazike të kontabilitetit dhe fianancave. Grupi duhet që të shkruaj aspekte të ndryshme të biznesit të propozuar për themelim. Nga grupi kërkohet që herë pas here të bëjë prezentime të pjesëve të ndryshme të planit të biznesit.

### Litaratura bazë që duhet ta përdorin studentët:

TITULLI	AUTORI	BOTUESI	DATA
<i>Biznesi i Vogël dhe i Mesëm: Krijimi, Menaxhimi dhe Rritja e Bizneseve,</i>	M. Mustafa, E. Kutllovci, P. Gashi dhe B. Krasniqi	Prishtinë: Instituti Riinvest.	2006
<i>Sipërmarrësia dhe Menaxhimi i Biznesit të Vogël</i>	Ariana Çepani	Tiranë: Shtëpia Botuese Pegi.	2001

### Litaratura shtesë / rekomanduar:

TITULLI	AUTORI	BOTUESI	DATA
<i>Small Business Management: An Entrepreneurial Emphasis</i>	Longenecker, J, Moore, C. dhe Petty, W.	Thomson South-Western.	2003
<i>Entrepreneurship and Small Firms</i>	Deakins, D. dhe Freel, M.	3 <sup>rd</sup> edition, McGraw Hill.	2003

### Plani i mësimit për një semestër:

**Java e parë: Ndërmarrësa dhe BVM në ekonominë kombëtare**

**Java e dytë: Idetë mbi ndërmarrësinë**

**Java e tretë: Motivet për ndërmarrësi**

**Java e katërt: Variantet e ndërmarrësisë**

**Java e pestë: Gjenerimi i ideve ndërmarrëse dhe teknikat për selektimin e tyre**

**Java e gjashtë: Punë ekipore (prezentimi i ideve ndërmarrëse)**

**Java e shtatë: Plani i Biznesit**

**Java e tetë: Format e organizmit të biznesit**

**Java e nëntë: Krijimi i vizionit dhe misionit të biznesit**

**Java e dhjetë: SWOT analiza dhe mjedisi i biznesit**

**Java e njëmbëdhjetë: Plani i marketingut-analiza e tregut**

**Java e dymbëdhjetë: Plani financiar – analiza financiare**

**Java e trembëdhjetë: Plani implementues (aksional)**

**Java e katërbëdhjetë: Ndërmarrësia dhe zhvillimi i BVM-ve në Kosovë (Roli i qeverisë dhe organizatave joqeveritare)**

**Java e pesëmbdhjetë: Testi 1**

**Detyrat (aktivitetet e mësimnxënjes) të cilat do të vlerësohen në orët mësimore:**

**Metodat e vlerësimit:**

Provimi final do të përmban disa pyetje që duhet të shkruhen në formë të eses së shkurtër. Në shkrimin e pyetjes-eses studentët duhet të jenë bindës në parashtrimin e fakteve duke dëshmuar se ata kanë njohuri rreth problemeve që shqyrtohen dhe mënyrave për zgjidhjen e tyre. Për studentët e rregullt gjatë vitit akademik notimi do të organizohet një test për Vlerësimi përfundimtar do të varet nga mesatarja e të gjitha aktiviteteve: testit, projektit individual dhe atij grupor. Secili aktivitet ka numër të caktuar të pikëve. *(Vërejtje: Pa përfundimin me sukses të gjitha aktiviteteve studenti nuk mund ta kalojë provimin dhe se duhet të nënshtrohet provimit përfundimtar. Po ashtu nëse studenti nuk i përfundon të gjitha aktivitetet me sukses duhet t'i nënshtrohet provimit të rregullt).*

**Ndërtimi i Notës:**

Për të përfunduar me sukses këtë modul studentët duhet që të dorëzojnë dy projektet dhe të përfundojnë me sukses provimin final. Pësia e secilit projekt dhe provimit përfundimtar është dhënë në vijim:

Projekti 1	Projekti 2	Provimi Final	Gjithsej
20%	20%	60%	100%

Nota përfundimtare përcaktohet nga mesatarja e ponderuar e notave të marra nga secili aktivitet i lartëshënuar. Për të përfunduar me sukses këtë modul studentët duhet të arrijnë së paku notën minimale prej 50% në provimin final, së paku 50% në projektin 1 dhe 2 ose më shumë në tërë modulin. Studentët këshillohen që mos të hyjnë në provim pa përfundimin me sukses të dy projekteve.

Vlerësimi përfundimtar i studentit llogaritet sipas mënyrave të mësipërme, ndërsa nga kufijtë e mëposhtëm të pikëve fitohen notat: